


Workshop-i Block II i programit të trajnimit për auditimet e performancës në kuadër të programit rajonal për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, organizuar online më 25-28 prill 2023

Në kuadër të programit rajonal për auditimet e performancës për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, u zhvillua në datat 25-28 prill 2023 online, workshop-i Block II i programit të trajnimit i organizuar nga SAI i Suedisë. Në zbatim të këtij projekti KLSH ka ndërmarrë auditimin e performancës, me temë “*Shërbimi i Policisë në Përgjigje të Qytetarëve*” i cili ka filluar në datë 28.12.2022 dhe është miratuar në datë 16.03.2023. Ka kryer fazën e terrenit dhe pret të përfundojë shkrimin e projektit me datë 19 maj 2023.

Përgjatë ditëve të zhvillimit të workshop-t online, u prezantuan koncepti i teorisë së ndryshimit (Theory of Change), projektimi i auditimit (Audit Design) si dhe strategjia e mbledhjes së të dhënave (Strategic Data Collection), ku pas prezantimit të secilit koncept, grupi përfaqësues i secilit SAI-i pjesëmarrëse prezantoi mbi këto koncepte bazuar në temën e zgjedhur për auditim, ku trajnerët e NAO Suedez dhanë rekomandimet e tyre.



Në këtë round u përmbvll shpjegimi i koncepteve si, teoria e ndryshimit, projektimi i auditimit dhe strategjia e mbledhjes së të dhënave. Grupet e secilit SAI-i pjesëmarrëse në prezantimet e tyre komunikuan se po vazhdojnë punën duke ndjekur udhëzimet e dhëna në trajnime dhe po aplikojnë rekomandimet e trajnerëve në auditimet e tyre.